



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 11540 (31010-00734-86-2016) Rregj.Them.
Data Regjistrimi 16.02.2016

Nr. (86-2016-156) 530 Vendimi
Datë 16.03.2016

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë prej :

GJYQTAR - Kastriot SELITA
GJYQTAR - Altina NASUFI
GJYQTAR - Rilinda SELIMI

Asistuar nga sekretare gjyqësore Valbona Zenelaj, në Tiranë, sot më datë 16.03.2016, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me palë:

PADITËS: Shoqëria tregtare "Coast to Coast" sh.p.k me adresë: Vlorë, Himarë, Dhërmi, Hotel Drymadhes.

I PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë.
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
Komisioni i Apelimit Tatimor.

OBJEKTI: Shfuqizimi i njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 11642, datë 22.07.2011 gjobë në vlerën 3.400.000 lekë, lënë në fuqi me vendimin nr. 16502, datë 14.11.2011 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

BAZA LIGJORE: Neni 118 të K. Pr. Administrative, neni 109 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, nenet 324, 325 të K. Pr. Civile.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 1809, datë 24.12.2015 ka vendosur :

1. *"Pranimin e kërkesë padisë.*
2. *Shfuqizimin e aktit administrativ njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 11642 Prot. datë 22.07.2011 gjobë në vlerën 3.400.000 lekë lënë në fuqi me vendimin nr. 16092, datë 14.11.2011 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.*
3. *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur".*

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ka paraqitur ankim pala e paditur në datën 04.12.2015 duke parashtruar shkaqet si më poshtë vijon:

Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ka paraqitur ankim pala e paditur DRT Vlorë dhe Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë duke parashtruar shkaqet si më poshtë vijon:

1. Inspektorët e Drejtorisë së hetimit tatimor kanë ushtruar kontroll pranë palës paditëse dhe kanë mbajtur akt konstatimin nr. 0139563, datë 12.07.2011 nga rezultoni se subjekti kishte kasë fiskale për çdo vend ku ushtronte aktivitetin. Ky subjekt në momentin e kontrollit kishte 17 dhoma të zëna me klientë dhe për këtë shërbim nuk kishte lëshuar kupon tatimor. Në bazë të këtij akt konstatimi është mbajtur dhe procesverbali i gjobës bazuar në nenin 122/1/b/i të ligjit nr. 9920/2008.
 2. Moslëshimi i kuponit tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave dhe shërbimeve, përbën shkelje administrative dhe penalizohet me gjobë bazuar në nenin 122/1/b/i të ligjit nr. 9920/2008.
 3. DAT Tiranë në vendimin e saj është shprehur se megjithëse nga kontrolli në vend nuk është konstatuar mosfunksionimi i pajisjes fiskale, subjekti duhet të përdorte dëftesën tatimore sipas modelit të përcaktuar në ligj. Nga ana e palës nuk është provuar ky fakt. Gjithashtu afati për riparimin e pajisjes fiskale nuk zgjat më shumë se dy ditë nga momenti i paraqitjes së ankesës për parregullsinë e pajisjes.
 4. Pala paditëse bazuar në udhëzimin nr. 16, datë 03.05.2010 pika 19 duhet të lëshojë dëftesë tatimore për çdo shitje me pakicë që realizon. Blloku me dëftesa tatimore do të furnizohet nga drejtoritë rajonale tatimore dhe do të jetë me nr. serial.
 5. Gjatë gjykimit të çështjes dhe jo më parë, pala paraqiti si akte provuese faturat e TVSH-së dhe dëftesat tatimore. Nga DRT Vlorë është kërkuar informacion dhe ka rezultuar se faturat e TVSH-së janë tërhequr në DRT Vlorë, ndërsa për dëftesat tatimore rezultoi se nuk janë tërhequr në DRT Vlorë.
 6. Pretendimi i shoqërisë se kasa fiskale ishte dërguar për riparim është i pabazuar, pasi në akt konstatimin e mbajtur nga inspektorët është shënuar se subjekti kishte kasë fikse për çdo vend ku kryente aktivitetet, ky subjekt kishte gjithsej 17 dhoma të zëna me klientë dhe për këtë shërbim nuk kishte lëshuar kuponin tatimor.
 7. Gjykata ka gabuar në dhënien e vendimit, pasi ajo në asnjë rast nuk ka konstatuar se veprimet e inspektorëve tatimorë janë në kundërshtim me ligjin apo procedurën, por ajo është marrë me faktin, i cili është shtrembëruar nga ana e palës paditëse.
 8. Inspektorët e hetimit tatimor gjatë kontrollit të ushtruar pranë këtij subjekti kanë konstatuar se subjekti nuk lëshonte kuponat tatimorë po ashtu dhe mungesën e dëftesave tatimore. Ky subjekt si gjatë kontrollit, po ashtu dhe gjatë ankimit në DAT nuk paraqiti dëftesa tatimore për shërbimin e kryer.
 9. Referuar vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duket qartë se është një vendim që nuk përmbush kriteret që ka një një vendim gjyqësor përsa i përket arsytimit të tij. Ky vendim përmban konsiderat teorike pa ju referuar rastit konkret dhe ta analizojë atë në lidhje me pretendimet e kërkuarit dhe provat përkatëse si dhe aftësinë provuese të tyre.
 10. Gjykata i ka interpretuar në mënyrë të gabuar provat e paraqitura prej palëve ndërgjyqëse, konkretisht gjykata ka deformuar faktin dhe është mjaftuar vetëm me parashtrimet e palës paditëse.
- Sa sipër DRT Vlorë dhe Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë kërkon ndryshimin e vendimit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj e në prova.
- Gjykata Administrative e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen në dhomë këshillimi, dëgjoi relacionin e përgatitur nga gjyqtari relator, si dhe analizoi shkaqet e ngritura në ankimet e paraqitura, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012, në këndvështrim me kërkesat e ligjit

material dhe procedural,

VËREN

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 14.12.2011 me kërkesë padi duke kërkuar:

Shfuqizimi i njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 11642, datë 22.07.2011 gjobë në vlerën 3.400.000 lekë, lënë në fuqi me vendimin nr. 16502, datë 14.11.2011 të Drejtorisë së Apelitit Tatimor.

Pala paditëse në lidhje me këto kërtime ka referuar si bazë ligjore në nenin 118 të K. Pr. Administrative, nenin 109 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, nenet 324, 325 të K. Pr. Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 1517, datë 16.05.2012 ka vendosur: Të pushojë gjykimin e çështjes civile nr. 3830 akt (1225) me palë paditës Coast to Coast shpk dhe palë të paditur DR Tatimeve Vlorë.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala paditëse në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. 81 (60-2013-391), datë 17.04.2013 ka vendosur: Prishjen e vendimit nr. 1517, datë 16.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjyimit në po atë gjykatë, me të njëjtin trup gjykues.

DRT Vlorë nëpërmjet shërbimit postar në datën 03.06.2013 ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë rekursin e saj ndaj vendimit nr. 81, datë 17.04.2013 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 2405, akti, datë 18.07.2013 ka vendosur:

“Pezullimin e gjyimit të çështjes nr. 2405 akti derisa të zgjidhet përfundimisht çështja gjyqësore në Gjykatën e Lartë...Urdhërohet sekretaria gjyqësore të kryejë veprimet përkatëse për dërgimin e çështjes në Gjykatën e Lartë”.

Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 49/2012, me vendimin e datës 28.04.2015 ka vendosur konstatimin e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për shqyrtimin e çështjes civile me nr. 2405/212 akti dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Vlorë.

Në këto rrethana Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka gjykuar çështjen në themel dhe me vendimin nr. 1809, datë 24.12.2015 ka vendosur: Pranimin e padisë së palës paditëse.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim pala e paditur DRT Vlorë dhe Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Vlorë për shkaqet e përshkruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Konstatohet se ankimet e paraqitura nga pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit janë përcjellë në Gjykatën Administrative të Apelit, duke u verifikuar kushtet e pranueshmërisë së tyre, e për rrjedhojë janë shoqëruar me vendimin e gjyqtarit që ka pranuar ankimet.

Në këto rrethana gjykata e shqyrtoi çështjen administrative të paraqitur nëpërmjet këtyre ankimeve në dhomë këshillimi sipas përcaktimeve të nenit 49/1 të ligjit nr. 49/2012.

Rrethanat e çështjes

Nga aktet e dosjes gjyqësore të përcjella me ankimin kundër vendimit nr. 1809, datë 24.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë rezulton se:

Shoqëria “Coast to coast” shpk është një shoqëri e rregjistruar që ushtron aktivitet në fushën bar-restorant hoteleri në Dhërm, Vlorë. Shoqëria është e pajisur me 3 kasa fiskale, një kasë e vendosur pranë receptionit të Hoteli, një kasë e vendosur pranë restorantit, si

dhe një kasë e vendosur pranë barit.

Në datën 09.07.2011 inspektorët e palës paditur DRT Vlorë kanë ushtruar kontroll pranë palës së paditur dhe kanë konstatuar se subjekti nuk lëshon kupon tatimor; lëshon kupon jo tatimor të pa miratuar nga Ministria e Financave.

Në lidhje me këtë konstatim inspektorët kanë mbajtur akt konstatim, që është firmosur pa komente nga përfaqësuesi ligjor i palës së paditur.

Rezulton se pala paditëse ka bërë kërkesë për kontroll kase fiskale pranë shoqërisë së autorizuar "A.E.Distribution"sh.p.k në datën 09.07.2011 ora 9:25 me qëllim ndërhyrje se "nuk printon kupon tatimor".

Në datën 12.07.2012 ora 18:40 inspektorët e Drejtorisë së Hetimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve kanë ushtruar kontroll pranë palës së paditur dhe kanë konstatuar se subjekti ushtronte aktivitetin bar-restornat dhe hotel me 29 dhoma dhe dispononte tre kasa fiskale. Subjekti kishte gjithsej 17 dhoma të zëna me klientë dhe për këtë shërbim nuk kishte lëshuar kupona tatimorë.

Në lidhje me këto konstatime është mbajtur akti i konstatimit i po kësaj date, që është firmosur rregullisht nga inspektorët e kontrollit dhe nga personi prezent për tatimpaguesin.

Në lidhje me këtë akt-konstatimi inspektorët e Drejtorisë së Hetimit kanë mbajtur procesverbalin e gjobës nr. 0059569 datë 12.07.07.2011 bazuar në nenin 122 pika 1 gërma b(i) të ligjit nr. 9920/2008 i ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 07.04.2011 me të cilin është vendosur të dënojë palën paditëse me gjobë në shumën 3.400.000 lekë. Procesverbali i gjobës është firmosur nga inspektorët dhe personi prezent i palës paditëse, i cili ka bërë shënimin "është prishur".

Për shërbimin e hotelerisë pala paditëse pretendon se ka lëshuar fatura tatimore me TVSH në datat 10, 11 dhe 12.07.2011. Fatura e datës 12. 07. 2011 është lëshuar nga pala paditëse për 17 dhoma në shumën 102.000 lekë me TVSH (fq. 6 e fashikullit, si dhe ka lëshuar deftesë tatimore për shërbim fjetje në hotel nga nr. 29 deri në nr. 41, të po kësaj date. (fq. 8-20 i fashikullit), por këto nuk janë pasqyruar në aktin e konstatimit dhe as në procesverbalin e gjobës të mbajtura nga inspektorët e palës së paditur.

DRT Vlorë bazuar në këtë procesverbal gjobe ka nxjerrë njoftim vlerësimi për detyrimet nr. 11642 Prot. datë 22.07.2011 ku përcaktohet detyrimi për tu paguar – gjobë në shumën 3.400.000 lekë për palën paditëse për kasa dhe kupon tatimor.

Pala paditëse ka ushtruar të drejtën ankimit ndaj njoftim vlerësimi për detyrimet nr. 11642 Prot. Datë 22.07.2011 të DRT Vlorë pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor duke kërkuar shfuqizimin e gjobës së vendosur në shumën 3.400.000 lekë. Në ankimin e paraqitur pala paditëse ka parashtruar se:

Në datën 09.07.2011 ka njoftuar shoqërinë "AE Distribution" shpk se kasa fiskale është prishur dhe në po atë datë kjo e fundit e ka marrë kasën për ta rregulluar. Në datën 13.07.2011 kasa është rregulluar dhe është rivendosur pranë recepsionit të hotelit. Në mungesë të kasës fiskale, në datat 10,11 dhe 12 Korrik 2011 pala paditëse pretendon se ka lëshuar fatura me TVSH dhe dëftesa tatimore për Hotelin.

Drejtoria e Apelimit Tatimor (DAT) me vendimin nr. 16092/1 Prot. datë 14.11.2011 ka vendosur:

"Lënien në fuqi të aktit objekt ankimi administrativ, Njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 11642 Prot. datë 22.07.2011 i Drejtorisë Rajonale tatimore Vlorë, për gjobën në vlerën 3.400.000 lek dhe rrëzimin e ankimit".

Në këtë vendim DAT ka argumentuar se:

Në VKM nr. 781, datë 14.11.2007 pika 13.2 përcaktohet se shoqëritë e autorizuar për mirëmbajtjen e sistemeve dhe pajisjeve fiskale sigurojnë stafin teknik për mirëmbajtjen e tyre...Mirëmbajtja e pajisjes fiskale, përfshirë dhe mirëmbajtjen e memories fiskale nuk duhet të zgjasë më shumë se dy ditë nga data e paraqitjes së ankesës për parregullsi.

Referuar udhëzimit nr. 16, datë 03.05.2010 "Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale" pika 19, në rast se pajisja fiskale nuk funksiononte ashtu siç pretendohet, megjithëse nga kontrolli në vend nuk është konstatuar mosfunksionimi i pajisjes fiskale, duhet të ishte përdorur deftesa tatimore sipas modelit të miratuar. Nga ana e juaj nuk është provuar se keni vepruar në përputhje me sa më sipër. Pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura nuk argumentojnë dhe provojnë ligjërisht se vlerësimi tatimor objekt ankimi është i pasaktë".

Në këto kushte pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 14.12.2011 me kërkesë padinë me objekt, bazë ligjore dhe palë të paditur siç përcaktohet në pjesën hyrëse të këtij relacioni.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 1517, datë 16.05.2012 ka vendosur:

Të pushojë gjykimin e çështjes civile nr. 3830 akt (1225) me palë paditës Coast to Coast shpk dhe palë të paditur DR Tatimeve Vlorë.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala paditëse në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. 81 (60-2013-391), datë 17.04.2013 ka vendosur: Prishjen e vendimit nr. 1517, datë 16.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë, me të njëjtin trup gjykues.

DRT Vlorë nëpërmjet shërbimit postar në datën 03.06.2013 ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë rekursin e saj ndaj vendimit nr. 81, datë 17.04.2013 të Gjykatës së Apeli Vlorë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 2405, akti, datë 18.07.2013 ka vendosur:

Pezullimin e gjykimit të çështjes nr. 2405 akti derisa të zgjidhet përfundimisht çështja gjyqësore në Gjykatën e Lartë..Urdhërohet sekretaria gjyqësore të kryejë veprimet përkatëse për dërgimin e çështjes në Gjykatën e Lartë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë në këtë vendim ka argumentuar se, pala e paditur në datën 05.06.2013 ka ushtruar rekurs ndaj vendimit nr. 391, datë 17.04.2013 të Gjykatës së Apelit Vlorë. Pamvarësisht këtij fakti, kryesekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë e ka futur çështjen në short duke moszbatuar detyrimin ligjor të dërgimit të dosjes në Gjykatën e Lartë. Në këtë situatë faktike jonormale procedurale të krijuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka nisur gjykimin duke urdhëruar njoftimin e palëve për seancën përgatitore. Pala e paditur në seancë ka kërkuar dërgimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, pasi duhet që ajo të shprehet më parë për vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë e më pas të rinisë gjykimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Në vijim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 28.04.2015 kryesisht ka verifikuar dosjet e pezulluara me vendimet e mëparshme nga ku ka rezultuar se dosja objekt gjykimi është pezulluar me vendimin e Gjykatës së datës 07.06.2013. Gjykata ka vendosur revokimin e vendimit të pezullimit duke qenë se ka ndryshuar një nga kushtet prezumimet procedurale absolute të procesit gjyqësor civil, sikurse është kompetenca lëndore në shqyrtimin e çështjes.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 49/2012 Gjykata me vendimin e datës 28.04.2015 ka

vendosur konstatimin e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për shqyrtimin e çështjes civile me nr. 2405/212 akti dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Vlorë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë me shkresën nr. 1294 akti, datë 14.10.2015 i ka kërkuar Informacion Gjykatës së Lartë lidhur me faktin nëse ekziston ose ka rënë shkaku i pezullimit të çështjes (nëse është marrë në shqyrtim rekursi për çështjen civile me palë si më sipër). Gjykata e Lartë me Shkresën nr. V-134/1 Prot. datë 29.10.2015 i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë ti vërë në dispozicion një kopje të vendimit nr. 81, datë 17.04.2013 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë me shkresë nr. 1788 Prot. datë 02.11.2015 i ka dërguar Gjykatës së Lartë sipas përmbajtjes së shkresës vendimin nr. 81, datë 17.04.2013 të Gjykatës së Apelit Vlorë, por bashkëngjitur kësaj shkrese është rekursi i datës 03.06.2013 i DRT Vlorë.

Gjykata e Lartë me shkresën nr. V-147/1 Prot. datë 10.11.2015 i ka kthyer përgjigje Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë se pas verifikimit të kryer sërish në sistemin informatik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë çështje me të dhënat e kësaj çështjeje, si dhe e ka informuar se për të marrë informacionin e duhur për çështjen që jeni interesuar duhet të sjelli të dhëna të sakta për datën e ardhjes së dosjes pranë Gjykatës së Lartë.

DRT Vlorë kërkoi kohë për të kërkuar informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë lidhur me fatin e rekursit, por ka konfirmuar se nuk ka mundur të sjellë informacion.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë pasi ka shqyrtuar çështjen në themel me vendimin nr. 1809, datë 24.12.2015 ka vendosur:

Pranimin e kërkesë padisë së shoqërisë “Coasttocoast” sh.p.k.

Nga përmbajtja e vendimit nr. 1809, datë 24.12.2015 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Vlorë rezulton se gjykata e shkallës së parë ka arritur në këtë zgjidhje me arsyetimin e mëposhtëm:

1. Shoqëria “Coast to coast” shpk ka interes legjitim në ngritjen e padisë, pasi nga vendimi i palës së paditur i cënohet interesi pasuror.
2. Çështja objekt gjykimi rregullohet ng aligji nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në R SH”.
3. Gjykata çmon se pala e paditur DRT Vlorë e ka nxjerrë njoftim vlerësimin tatimor datë 22.07.2011 në kundërshtim me ligjin. Nga procesverbali i gjobës ndatë 12.07.2011 tek nënshkrimi i tatimpaguesit është shënuar “kasa është prishur” dhe nga inspektorët tatimorë nuk është kryer asnjë verifikim nëse kasa është vërtet e prishur. Vetëm pasi të verifikohet nëse kasa ishte prishur ose jo dhe pastaj të dilej me vendim dënimi me gjobë. Është detyrim i organit publik që të provojë në mënyrë të plotë dhe të saktë se tatimpaguesi ka shkelur ligjin për procedurat tatimore.
4. Rezultoni se pala paditëse ka prerë fatura tatimore në shitje në datat 10, 11 dhe 12.07.2011 kur është kryer kontrolli me nr. 10.11. dhe 12 fature. Gjithashtu pala paditëse ka paraqitur edhe 15 dëftesa tatimore me numrat përkatëse të lëshuara në datën 12.07.2011 lidhur me shërbimin që ka ofruar për hotel.
5. Pala e paditur gjatë gjykimit nuk ka provuar dhe ishte barra e saj provuese që të provonte se faturat tatimore të shitjes dhe dëftesat tatimore të lëshuara nga subjekti ishin lëshuar ose jo konform ligjit “Për procedurat tatimore”.

6. Gjykata çmon se subjekti "Coast to Coast" shpk për çdo shërbim të ofruar në veprimtarinë e hotelit ka prerë faturën tatimore të shitjes në vlerën totale prej 102.000 lekë me TVSH dhe ndërkohë që rezulton se edhe nga dëftesat tatimore kjo vlerë me TVSH është 102.000 lekë, pra korrespondojnë me njëra-tjetrën.
7. Sa më sipër, Gjykata çmon se njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 11642, datë 22.07.2011 në vlerën 3.400.000 lekë lënë në fuqi me vendimin nr. 16092, datë 14.11.2011 të Drejtorisë së Apelit Tatimor duhet të shfuqizohen si akte administrative të nxjerrë në kundërshtim me ligjin.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim DRT Vlorë dhe Avokatura e Shtetit, duke këkuar ndryshimin e vendimit nr. 1809, datë 24.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe rrëzimin e padisë së palës paditëse si të pabazuar në ligj e në prova.

Gjykata Administrative e Apelit i shqyrtoi ankimin në dhomë këshillimi duke analizuar tërësinë e rrethanave faktike në referim të përcaktimeve të ligjit të zbatueshëm në rastin konkret.

Vlerësimi i gjykatës

Në analizë të ankimit dhe shkaqeve të ngritura nëpërmjet tij, akteve të dosjes së gjykimit, si dhe të vendimit objekt ankimi, Gjykata Administrative e Apelit çmon se vendimi nr. 1809, datë 24.12.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është rrjedhim i një procesi të zhvilluar në respektim të dispozitave të ligjit procedural. Nga ana tjetër Gjykata e Shkallës së Parë ka gabuar në zbatimin e ligjit material që gjen zbatim në rastin objekt gjykimi e për rrjedhojë ky vendim duhet të ndryshohet dhe padia e shoqërisë tregtare "Coast to coast" sh.p.k duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj e në prova.

Së pari: Pala e paditur në ankimin e paraqitur prej saj përpara Gjykatës Administrative të Apelit ka parashtruar se akti i konstatimit i datës 12.07.2011 dhe procesverbali i gjobës nr. 0059569 i po kësaj date i nxjerrë bazuar në këtë akt konstatimi provojnë se pala paditëse ka kryer kundërvajtjen administrative të moslëshimit të kuponit tatimor për shërbimin e hotelerisë për 17 dhoma hoteli, të kryer nga pala paditëse.

Gjykata Administrative e Apelit çmon se ky pretendim i parashtruar në ankimin e saj nga pala e paditur dhe avokatura e shtetit është i bazuar në ligj e në prova dhe si i tillë duhet pranuar.

Konkretisht, në datën 12.07.2012 ora 18:40 inspektorët e Drejtorisë së Hetimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve kanë ushtruar kontroll pranë palës së paditur dhe kanë konstatuar se subjekti ushtronte aktivitetin bar-restorant dhe hotel me 29 dhoma dhe dispononte tre kasa fiskale. Subjekti kishte gjithsej 17 dhoma të zëna me klientë dhe për këtë shërbim nuk kishte lëshuar kupona tatimorë.

Në lidhje me këto konstatime është mbajtur akti i konstatimit i po kësaj datë, që është firmosur rregullisht nga inspektorët e kontrollit dhe nga personi prezent për tatimpaguesin. Personi prezent për palën paditëse në momentin e mbajtjes së akt konstatimit dhe të procesverbalit nuk ka deklaruar se janë lëshuar dëftesa tatimore dhe fatura me TVSH për të provuar transaksionin e kryer por shërbimin e hotelerisë për 17 dhoma.

Ky i fundit ka deklaruar përpara inspektorëve të palës së paditur se kasa është prishur, fakt ky që vërtetohet me procesverbalin e mbajtur në datën 09.07.2011 ndërmjet shoqërisë "AE Distribution" shpk dhe palës paditëse në lidhje me shërbimin e kryer për kasën fiskale që ishte prishur.

Personi prezent për palën paditëse në momentin e mbajtjes së procesverbalit nuk ka

deklaruar se për këto dhoma ka lëshuar dëftesa tatimore për të provuar transaksionin e kryer për shërbimin e hotelerisë për 17 dhoma, por ka deklaruar se kasa “është e prishur”. Ndërsa nga ana tjetër deftesat tatimore të lëshuar dhe fatura me TVSH nuk janë pasqyruar në aktin e konstatimit dhe as në procesverbalin e gjobës të mbajtura nga inspektorët e palës së paditur.

Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit çmon si të pabazuara në rrethanat e faktit pretendimin e palës paditëse se në momentin e kontrollit të kryer nga inspektorët e palës paditëse kishte lëshuar dëftesë tatimore dhe faturë me TVSH për shërbimin e hotelerisë për 17 dhoma.

Së dyti: Gjykata Administrative e Apelit çmon të bazuar në ligj dhe në rrethanat faktike të kundërvajtjes administrative të kryer nga pala paditëse dhe të konstatuar nga inspektorët e palës së paditur njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore nr. 11642, datë 22.07.2011 të DRT Vlorë me të cilën është dënuar pala paditëse me gjobë në vlerën 3.400.000 lekë, i lënë në fuqi me vendimin nr. 16502, datë 14.11.2011 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Gjykata çmon se ky, akt administrativ i DRT Vlorë është bazuar në konstatimin e kryer nga inspektorët e palës së paditur se pala paditëse nuk ka lëshuar kupon tatimor për shërbimin e hotelerisë për 17 dhoma.

Neni 54 i ligjit nr. 9920/2008 përcakton se:

“1. Kuponi tatimor është dokumenti i lëshuar me anë të pajisjeve fiskale apo të pajisjeve të tjera elektronike me aparat shtypshkrimi.

2. Subjektet, që detyrohen të lëshojnë kupona tatimorë lëshojnë njëherazi edhe faturë, nëse shitja apo shërbimi i kryer është për një përdorim tregtar dhe, për këtë shkak, blerësi është i detyruar ta kërkojë faturën.

3. Të gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise apo njësi të përhershme, të hapura për publikun, duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimorë për çdo transaksion.

4. Kuponi tatimor, i pashoqëruar me faturë, nuk njihet si dokument justifikues i shpenzimeve për blerësin, ushtrues të një veprimtarie tregtare”.

Në rastin konkret pala paditëse nuk provon se në momentin e kontrollit ka lëshuar dëftesë tatimore dhe faturë me TVSH për shërbimin e hotelerisë së kryer për 17 dhoma.

Në analizë të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë, rezulton se nga ana e gjykatës së shkallës së parë është vlerësuar vetëm fakti i paraqitjes nga pala paditëse të dëftesave tatimore të datës 12.07.2011 dhe të faturës tatimore me TVSH të po të njëjtës datë.

Faktet e pretenduara, si dhe ato të pasqyruar në një akt të një punonjësi shtetëror siç është në rastin konkret edhe akti i konstatimit i mbajtur nga Inspektorët e DRT Vlorë, duhet të provohen përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në rastin konkret, nga të gjithë provat e marra në gjykimin në shkallë të parë, rezulton të jetë e provuar dhe madje e pranuar edhe nga pala paditëse, se: Inspektorët e DRT Vlorë kanë ushtruar kontroll në ambientet ku paditësi ushtron aktivitetin e tij tregtar të shërbimit të hotelerisë, si dhe është provuar fakti se paditësi ka patur kasën fiskale të prishur, dhe nuk ka lëshuar dëftesa tatimore që provojnë transaksionin për shërbimin e hotelerisë së kryer prej tij.

Në lidhje me faktet e pretenduara nga paditësi, se ka lëshuar dëftesë tatimore dhe faturë tatimore me TVSH, nga provat e marra në gjykimin në shkallë të parë nuk rezulton që pala paditëse të ketë provuar pretendimet e parashtruara prej tij nëpërmjet padisë si dhe me parashtrimet e bëra para gjykatës. Nuk rezulton që direkt ose indirekt nga provat e

marra në gjykim, të rezultojë se gjendja e konstatuar nëpërmjet akt konstatimit të mbajtur nga inspektorët e palës së paditur të mos jetë e saktë apo të jetë e ndryshme. Vetë pala paditëse ka konfirmuar faktin se kasa është e prishur, por nuk ka konfirmuar faktin që: në kushtet e prishjes së kasës, ai ka përmbushur detyrimin ligjor për të lëshuar faturë tatimore. Në këto rrethana, pretendimet e palës paditëse të parashtruara në shkallës të parë, rezultojnë të pabazuara në ligj e në prova e si të tilla të papranueshme

Së treti: Në lidhje me masën e gjobës, Gjykata Administrative e Apelit çmon se pala e paditur me të drejtë e ka bazuar në nenin 122 pika 1 gërma "b" (i), në të cilin përcaktohet se masa e gjobës në rastet e konstatimit të parë të shkeljes administrative të moslëshimit të kuponit tatimor nga tatimpaguesi, ky i fundit dënohet me gjobë në masën 200.000 (dyqind mijë) lekë për çdo rast konstatimi.

Në rastin konkret është konstatuar se subjekti "Coast to cast" shpk nuk ka lëshuar kupon tatimor për 17 raste të dhënies së shërbimit të hotelerisë e për pasojë Gjykata vlerëson se masa e gjobës së vënë nga inspektorët e palës së paditur është në përputhje me dispozitën ligjore të sipërcituar.

Në këto rrethana Gjykata Administrative e Apelit, çmon se padia e shoqërisë "Coast to coast" shpk është e pabazuar në prova dhe në ligj në lidhje me çfarë kërkon paditësi nëpërmjet kësaj padie dhe si e tillë ajo duhet të rrëzohet.

Në rrethanat e përshkruara sa më sipër Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma "c" të ligjit Nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", çmon se vendimi nr. 1809, datë 24.12.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë duhet të ndryshohet dhe padia e shoqërisë tregtare "CoasttoCoast" sh.p.k, të rrëzohet si e pabazuar në ligj e në prova.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50 gërma "c" të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*",

VENDOSI :

1. Ndryshim e vendimit nr. 1809, datë 24.12.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
2. Rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj.
3. Shpenzime gjyqësore nuk ka.
4. Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot më datë 16.03.2016.

GJYQTAR
Rilinda SELIMI
d.v

GJYQTAR
Altina NASUFI
d.v

GJYQTAR
Kastriot SELITA
d.v

Vertetohet njesia me origjinalin

Kancelari
Leonid Steady
Bardaj